



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIMAL  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 05 DATË 28.02.2022

**MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR 6 % PËR VITIN 2022**

Këshilli Bashkiak Dimal në mbledhjen e tij të datës 28.02.2022 bazuar në materialin e përgatitur/paraqitur nga Sektori i Ndiemes Ekonomike, në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Neni 24, Neni 53, Neni 54, Neni 55, në mbështetje të Ligjit Nr 9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, pika 13 e Kreut II, VKM Nr 955 datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", Udhëzimit Nr 5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike "deri në 6 % të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Socialë, në mbështetje të Udhëzimit Nr 8 datë 08.05.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr 3 datë 17.02.2017 "Mbi zbatimin e vendimit Nr 955 datë 07.12.2016 të "Këshillit të Ministrave" Për përcaktimin e kriterëve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", Udhëzimit Nr 4 datë 17.02.2017 "Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike, si dhe VKB Nr 2 datë 19.01.2018 "Miratimi i kriterëve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike 6 %, Zbatimit të udhëzimit të Aktit të Kontrollit, me Nr prot 79/2 datë 15.04.2021, nga Shërbimi Social Rajonal Berat, Urdhërit me Nr 540 datë 13.02.2020, VKB Nr 03 datë 25.02.2020, VKB nr 21 datë 02.06.2021, për miratimin e kriterëve cdo vit sipas legjislacionit përkatës në fuqi

## VENDOSI

### Me 15 vota PRO nga 15 Këshilltarë prezentë në mbledhje të miratojë:

1. Të miratohen kriteret e ndihmës ekonomike nga fondi i ksuhtëzyar 6 % për vitin 2022 si më poshtë vijon :

1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit
  2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale
  3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune( nuk kanë përfituar pension)
  4. Familje me shumë fëmijë(mbi 3 fëmijë)
  5. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë që ndjekin studimet universitare
  6. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftësi/invalid pune,në vështirësi ekonomike.
  7. Familje që kanë në përbërjen e tyre, vetëm 2 anëtarë ( kryefamiljari dhe bashkëshortja), të grup moshës 50-60 vjec e deri në moshë pensioni.
- II. Dokumentat e aplikuesve të jenë sipas VKM Nr 955 datë 07.12.2016 : për përcaktimin e kriterëve ,të procedurave,dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike.
- III. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM-së Nr 955 datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve,të procedurave,dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”,Udhëzimit Nr 4 datë 17.02.2017 “Për përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”
8. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi Kryetari i Bashkisë Dimal, Sektori i NDihmës ekonomike, Drejtoria e Financës, Administrata e Bashkisë Dimal
  9. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij



